



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2020:069897

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05415751

**E.nr.1603/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit F.S. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 06.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.1603/2022**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1603/2022, të datës 19.12.2022, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.980/20, të datës 20.04.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 13.03.2023 dhe 06.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, t'i transferoj shumat e mjeteve prej 1,925.00 euro dhe 310.68 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.1603/22, më datë 06.03.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**